**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 508/20 Nr. i faq/Br.str/No.pg 51
Data/Datum/Date 22 / 01 / 20
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 02/227/20 të datës 20.01.2020 për caktimin e zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit kundër korrupsionit 2018-2021, pas monitorimit dhe mbledhjes së informatave nga Drejtoritë, Sektorët dhe Kabineti i Kryetarit, në cilësinë e zyrtarit përgjegjës të caktuar nga Kryetari i Komunës, hartoj këtë:

# INFORMATË

Komuna e Rahovecit, me Vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit Nr. 1970 të datës 28.06.2018, ka miratuar Planin Strategjik të Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2021, i cili tregon përkushtimin dhe vullnetin e Komunës së Rahovecit në përmirësimin e kontrolleve ekzistuese në luftën kundër korrupsionit.
Ky plan ka për qëllim ritjen e mundësisë organizative për reduktimin dhe eliminimin mundësive për korrupsion si dhe forcimin e rezistencës ndaj shkeljeve eventuale korruptive në Komunën e Rahovecit, si dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës në sistemin e menaxhimit komunal.
Në vijim do ju informoj për masat e ndërmarra dhe objektivat e arritura nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtoritë dhe zyrtarët e strukturat e tjera në zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit në vitin 2019.

## Objektivat strategjike dhe masat e ndërmarra

Siç parashihet edhe në Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit 2018-2021, me vendim të Kryetarit të Komunës është caktuar personi përgjegjës (Mirsad Shala) i cili do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Veprimit Kundër Korupsionit në Komunën e Rahovecit;
Njësia e Personelit, në bashkëpunim me ministritë dhe agjencionet përkatëse të cilat merren me trajnime me qëllim të ngritjes së vetëdijes për eliminimin e mundësive për korrupsion, ka dërguar zyrtarë të ndryshëm në trajnime, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për zbatimin e Planit;
Organet e administratës komunale, në bazë të strukturës organizative janë maksimalisht të përkushtuara për marrjen e masave parandaluese me qëllim të parandalimit të përhapjes së kësaj dukurie negative, nëpërmjet rritjes së vazhdueshme të llogaridhënies dhe transparencës në punët administrative;

## Kabineti i Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës mbanë mbledhjet e rregullta javore dhe periodike me Këshillin e drejtorëve të Komunës së Rahovecit, me qëllim të ndërmarrjes së hapave konkret dhe të koordinuar, për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe palët konkrete, ku përmes këtyre takimeve rritet transparenca dhe llogaridhënia e ekzekutivit të komunës.
Transparenca dhe llogaridhënia komunale bëhet gjithashtu në lidhje me menaxhimin e sistemit financiar të komunës, ku ekzekutivi i komunës mban dëgjimet e rregullta buxhetore, siç janë të parapara me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
Gjatë vitit paraprak, Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka bërë regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve të Komunës së Rahovecit, në të cilën poashtu ka bërë edhe regjistrimin dhe vlerësimin e pronave.

## Prokurimi Publik

Sektori i Prokurimit është duke funksionuar me stafin, i cili posedon përgatitjen e nevojshme për zhvillimin e procedurave të konkurimit dhe specifikimet e tenderit. Në këtë aspekt, në tërë procesin e prokurimit ekziston transparenca duke filluar nga konkurueshmëria e hapur, vlerësimi i aplikacioneve bëhet duke formuar komisione profesionale e deri te shpallja e përfituesve. Në këtë aspekt nuk mungon as trajnimi i kohëpaskohshëm i stafit në Sektorin e Prokurimit, me qëllim të përgatitjes sa më të mirë profesionale, në udhëheqjen e proceduarve të prokurimit publik. Në këtë aspekt, siç parashihet edhe me ligjin e prokurimit, për monitorimin e kontratave dhe kontrollin e punëve caktohen menaxherët e kontratave, të cilat bëjnë monitorimin dhe kontrollin e përmbushjes së detyrave të cilat dalin nga kontratat. Të gjitha kontratat e nënshkruara me operator të ndyshëm, janë të publikuar në zyrtare të komunës uebfaqen në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/prokurimi/kontratat-e-nenshkruara/?page=2019.

## Menaxhimi dhe Zhvillimi i Burimeve Njerëzore

Njësia e Personelit, siç parashihet edhe me legjislacionin në fuqi, pas aprovimit nga ministria përkatëse, e zhvillon procedurën e rekrutimit, sipas ligjit, ku në fillim bën hapjen e konkursit të brendshëm dhe pastaj konkursin e jashtëm, dhe kandidatët kanë të drejtë konkurueshmërie sipas ligjit. Për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm formohet komisioni, i cili në fund bën edhe vlerësimin, duke u bazuar në kriteret e qarta të parapara me ligj. Njoftimet për konkurse dhe njoftimet për përzgjedhjen e kandidatëve publikohen në uebfaqe në vegëzën: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/shpalljet/

## Auditimi i Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Rahovecit është e kompletuar me staf profesional dhe të trajnuar, të cilat punojnë dhe bazohen ne ligjet dhe aktet nënligjore të auditimit të brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm në planin e saj të punës i ka të caktuara autitimet të cilat i kryen brenda vitit, por gjithashtu Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë edhe disa auditime, të cilat janë

bërë me kërkesë të Kryetarit të Komunës. Rekomandimet e dhëna nga Njësia e Auditimit, e obligojnë ekzekutivin e Komunës që në të ardhmen të eliminojnë ato. Raportet e Zyrës së Auditimit të Brendshëm janë të publikuara në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/01/Raporti-Janar-Dhjetor-2019-11.pdf

## Shërbimet Publike

Në këtë drejtori trajnimet e stafit bëhen sipas radhës dhe nevojave të cilat paraqiten në punët e përditshme. Sistemi i raportimit në kryerjen e detyrave të kësaj drejtorie është i paraparë në mënyrë periodike dhe vjetore, duke u bazuar në planet dhe detyrat e punës të përcaktuara nga kjo drejtori dhe stafi i saj.

Kontaktet e drejtpërdrejta të zyrtarëve të kësaj drejtorie me palët janë minimizuar në masë, pasi që kërkesat e palëve dorëzohen në zyrën e pranimit e cila funksionon e ndarë, dhe se përcjellja e kërkesave në këtë drejtori bëhet nga zyrtarët e pranimit dhe sistemit të brendshëm INTRANET.

Planifikimi dhe vendosja e prioriteteve në këtë drejtori bëhet sipas radhës dhe sipas kritereve.

Të gjitha projektet e kësaj drejtorie janë nën mbikëqyrjen e një organi mbikëqyrës i cili bën mbikëqyrjen e të gjitha projekteve të cilat janë në këtë drejtori.

Kjo drejtori e ka të rregulluar sistemin ligjor, duke përfshirë edhe aktet komunale dhe punon në bazë të rregulloreve dhe ligjeve të parapara.

## Kadastri

Punonjësit dhe stafi i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit, kohë pas kohë në bashkëpunim me Njësinë e Personelit janë dërguar në trajnime, ku janë njoftuar me procedurat dhe kornizat e matjeve kadastrale, si dhe me kornizën ligjore në fuqi. Në këtë drejtori nuk është raportuar ndonjë parregullsi në afatet ligjore të kthimit të përgjigjeve, në dokumentacion apo në ankesat publike, pasi që stafi u është përgjigjur të gjitha kërkesave, ankesave, regjistrimeve të hipotekave me kohë dhe në afate ligjore.

Të gjitha kërkesat si dhe pagesat e taksave administrative të cilat lidhen me këtë drejtori, janë të rregulluara në mënyrë ligjore, pasi që palët e bëjnë kërkesën te zyra e pranimit, më pastaj në afate ligjore i pranojnë shërbimet e tyre.

Kërkesat e pranuara merren parasysh dhe zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe sipas radhës së numrit rendor, përpos kërkesave, të cilat janë paraqitur në numër të pakët, kanë kërkuar informatë shtesë apo dokumentacion shtesë, e me të cilat sipas informatave nga drejtoria janë kërkuar me kohë nga parashtruesit e kërkesave. Kjo drejtori në vazhdimësi bënë publikimin e vendimeve për uzurpim të pronës në këtë vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/kadastri/vendimet/

## Inspektimi

Drejtoria për Inspektim, duke u bazuar në kapacitetin e stafit të inspektorëve të cilat i ka në dispozicion ka bërë punë efektive, ku llogaridhënia dhe transparenca ka qenë në nivelin e duhur, duke u bazuar në informatat e marra nga drejtoria e lartëpërmendur.

Inspektorët komunalë, duke marrë parasysh numrin dhe vëllimin e punëve, përpos orarit të rregullt të punës janë në terren edhe jashtë orarit të punës si dhe gjatë ditëve të vikendit, ku Kryetari i Komunës me vendim i ka autorizuar inspektorët komunalë që të jenë në detyrë.
Me këtë, është bërë mbulimi i zbrazëtirave eventuale të kapaciteteve të stafit të kësaj drejtorie, dhe se në bazë të raporteve të paraqitura, është vërejtur një përmirësim i dukshëm në punën e inspektorëve, gjithashtu, edhe në zvogëlimin e keqpërdoruesve eventual.
Për largimin e keqpërdorimeve, inspektorët gjatë inspektimeve kanë hasur edhe në ekonomi informale, të cilat janë evidentuar në raporte të regjistruara në drejtori, si dhe të njëjtët, me kërkesë dhe urdhër të kësaj drejtorie janë futur në sistem.

## Urbanizmi, Planifikimi dhe Mbrojtja e Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në strukturën organizative të saj e ka forcuar mekanizmin e kontrollit, duke e bërë hierarkinë e punëve dhe mbikëqyrjen periodike të punëve të cilat dalin nga kjo drejtori.
Gjatë përpilimit dhe ndryshimit të planeve rregulluese, kjo drejtori i ka të mbajtura disa dëgjime publike, pasi që të njëjtët janë të rregulluara edhe me akte nënligjore të aplikueshme, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.
Në procedurën e rregullimit të dokumentacionit, në punët të cilat dalin nga kjo drejtori nuk është hasur ndonjë raport ku nëpunësit civil kanë kërkuar dokumentacion shtesë, përpos dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e punëve, të parashikuara me ligj dhe akte të tjera nënligjore.
Punët e kryera në këtë drejtori, sipas informacionit të marrë janë kryer sipas radhës së parashtrimit të kërkesave dhe se nuk ka pasur vonesa në kthimin e përgjigjeve.
Kjo drejtori për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies është duke publikuar dhënien e lejeve ndertimore : https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2020/03/Lejet-ndertimore-per-vitin-2019.pdf dhe lejet mjedisore komunale : https://kk.rks-gov.net/rahovec/urbanizem/leje-mjedisore-komunale/?page=2019 .

## Bujqësia

Drejtoria e Bujqësisë, ka prezantuar planin e trajnimeve për punonjësit e saj, të cilat në mënyrë periodike i kanë mbajtur me institucionet adekuate për trajnimin e stafit të saj.
Sistemi i koordinimit, komunikimit dhe bashkëpunimit me fermerët ka qenë në nivelin e duhur dhe se të njëjtët janë informuar për secilin veprim, të cilin e ka marrë kjo drejtori për t'i shërbyer komunitetit.
Gjithashtu, kërkesat e paraqitura në këtë drejtori janë marrë parasysh sipas radhës së paraqitjes së tyre.

## Arsimi

Drejtoria për Arsim, duke u bazuar në raportin e saj si dhe informatat e marra, është parë se të gjitha konkurset e paraqitura për rekrutimin e stafit të sektorit të arsimit janë bërë sipas procedura dhe rregullave të parapara me ligj dhe akte të tjera nënligjore.

Në të gjitha konkurset e paraqitura, është bërë publikimi i të gjitha informatave të nevojshme: prezantimi i listave të kandidatëve të cilat kanë konkururar si dhe publikimi i rezultateve përfundimtare. Procesi intervistues është bërë sipas kushteve të parapara me ligj, ku në të gjitha panelet intervistuese si në stafin administrativ ashtu edhe në stafin e mësimdhënësve, janë përfshirë edhe anëtarët e jashtëm siç parashihet me ligj.
Kjo drejtori ka kontakte të vazhdueshme me Ministrinë e Arsimit në lidhje me ndryshimet eventuale ligjore dhe dhe udhëzimet për rregulloret në fuqi.

## Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik në Komunën e Rahovecit është i përcaktuar me kornizën afatmesme të veprimit, të përpiluar nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ku është paraparë qëndrueshmëria ekonomike dhe zhvillimore. Kjo drejtori në raportet dhe informtatat e pranuara, në përbërjen e saj e ka stafin e domosdoshëm për përpilimin e politikave zhvillimore ekonomike dhe në turizëm.
Përparësi e kësaj politike i është dënë sektorit privat për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme në territorin e Komunës së Rahovecit.
Në raportin e saj, vlen të theksohet se për herë të parë e ka bërë edhe regjistrimin dhe vlerësimin e të gjitha aseteve komunale si dhe regjistrimin dhe vlerësimin e të gjitha pronave komunale.

# Objektivat dhe masat e ndërmarra për zbatimin e tyre

- Masat e ndërmarra për zbatimin e këtyre objektivave janë në nivelin e kënaqshëm, pasi që të gjitha planet komunale, planet buxhetore, si dhe masat e ndërmarra strategjike, ju mundësohet pjesëmarrja e qytetarëve përmes njoftimeve, mbajtjes së debateve publike si dhe informimit me kohë të qytetarëve në mënyra të ndryshme për të gjitha çështjet strategjike komunale;
- Në mënyrë që transparenca dhe llogaridhënie të jetë e hapur, uebfaqja komunale përditësohet me informata përkatëse ditore, lidhur me politikat dhe arritjet;
- Duke pasur parasysh angazhimin e plotë kundër korrupsionit, gjithashtu është ritur niveli i bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe me Agjencinë Kundër Korrupsionit, ku Komuna e Rahovecit e ka të caktuar edhe zyrtarin përgjegjës, i cili mbanë kontakte të rregullta në mes të institucionit të Komunës dhe AKK-së;
- Masë tjetër e ndërmarrë nga Kryetari i Komunës, e cila ka të bëjë me planin strategjik kundër korrupsionit është se me vendim të veçantë është caktuar edhe zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve, e cila është e paraparë me ligj;
- Vlen të theksohet, se Komuna e Rahovecit nuk ka asnjë rast të lajmëruar për korrupsion, gjë që duhet të mbetet edhe synim i qeverisë komunale të vazhdojë edhe në të ardhmen me transparencën dhe luftimin e korrupsionit;
- Një masë tjetër e cila vlen të përmendet për luftimin e korrupsionit, është se Komuna e ka edhe linjën e sigurt telefonike, ku shoqëria civile si dhe komuniteti i biznesit mund të lajmëroj rastet eventuale. Kjo linjë telefonike është në dispozicion pa pagesë për qytetarët e komunës së Rahovecit.
- Të gjitha vendimet, të cilat merren nga Kryetari i Komunës publikohen menjëherë në uebfaqen elektronike të komunës, gjë që e rrit transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve të komunës.

- Mbledhjet e Kuvendit Komunal transmetohen drejtpërdrejtë dhe janë të hapura për publikun, pasi komuna e ka të kontraktuar median lokale, e cila e bën transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve.
- Vlen të theksohet se në mënyrë që transparenca dhe llogaridhënia të jetë në nivelin e kërkuar nga ministritë dhe OJQ-të qeveritare dhe ato joqeveritare që bëjnë monitorimin e komunës, në vazhdimësi janë duke u publikuar vendimet të cilat nënshkruhen nga Kryetari i Komunës, publikohen edhe draft-rregulloret që duhet të dalin në debat-konsultim publik, të cilat pas miratimit në Kuvendi Komunal dhe aprovimit të ligjshmërisë ato publikohen në uebfaqen zyrtare të komunës.
- Në vazhdimësi janë publikuar edhe draft-planet e ndyshme dhe pas miratimit në Kuvendi Komunal, të njëjtët janë publikuar në uebfaqen zyrtare ashtu siç edhe kërkohet.
- Komuna e Rahovecit vazhdon të vlerësohet pozitivisht në pjesën e transparencës dhe llogaridhënies.
- Në këtë drejtim, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Komuna e Rahovecit vlerësuar me vendin e parë, si më transparentja në mesin e 38-të komunave në nivel vendi.
- Vlerësim pozitiv komuna ka marrë edhe nga KDI dhe OJQ të tjera që bëjnë monitorimin e komunës përgjatë gjithë vitit.
- Përkushtimi i Kryetarit të Komunës dhe zyrtarëve përgjegjës, janë vlerësuar pozitivisht dhe puna që është duke u bërë po nga këta zyrtarë, mund të themi se niveli i transparencës dhe llogaridhënies do të jetë i lartë në vazhdimësi.

## PËRFUNDIM

Të nderuar kuvendarë,

Jemi të vetëdijshëm se lufta kundër korrupsionit është detyrë e jona ligjore, është zotimi ynë publik dhe obligim i secilit qytetar të komunës sonë.
Komuna e Rahovecit, vazhdon të jetë e përkushtuar, në luftën kundër korrupsionit dhe respektimin e sundimit të ligjit në mbarë territorin e komunës së Rahovecit.
Përpjekja jonë për zbatimin e planit strategjik komunal kundër korrupsionit, do të jetë më e përqendruar, më dinamike dhe më gjithëpërfshirëse.
Andaj, ju inkurajojmë dhe jemi të hapur që bashkërisht dhe pa asnjë ngurrim të gjithë pa dallim, ta luftojmë korrupsionin pa pushim, kudo që haset ta raportojmë atë tek organet përgjegjëse, në mënyrë që të sigurohemi se, korrupsioni nuk ka vend në shoqërinë tonë.

***Ju faleminderit***

***Me respekt***
***Mirsad Shala***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.03.2020,** me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:
**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!
Të nderuar kuvendarë, kërkoj falje për pjesën tjetër të materialit fizik që s'kemi mundur me ju dërgua për shkak të numrit të reduktuar që kemi në administratë dhe rrethanave që jemi nga virusi Covid-19.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

**REND DITE**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit lokal për veprim në mjedis për vitin 2019-2024,**
4. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit komunal të veprimit për eficiencë për vitin 2019-2020,**
5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje të interesit të përgjithshëm parcela Nr.P-71510068-01713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc,**
6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale në fshatin Radostë,**
7. **Shqyrtimi i raportit të menaxhimit të asetëve komunale për vitin 2019,**
8. **Shqyrtimi i informatës së listës së pronave komunale dhe menaxhimi i tyre**
9. **Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për ndarje të mjeteve financiare,**
10. **Shqyrtimi i propozim vendimit për dalje në ndihmë bizneseve të komunës së Rahovecit.**

**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendarë, ky është rendi i ditës për sot mirëpo kemi edhe një pikë shtesë të propozuar nga Kryetari i Komunës i cili i propozon Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të ndajë mjete me shumën prej 10.000 euro, për shkak të gjendjes e cila ka kapluar vendin tonë nga epidemia Corona virus. Pra këto mjete do të përdoren për rast nevoje për dalje nga kjo epidemi. A pajtoheni edhe ju që ta kemi edhe këtë pikë shtesë!
**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit Komunal, drejtorat e drejtorive dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sa i përket kësaj pike, unë veç deshta të them diçka se ne qysh në fillim të muajit mars, jemi futur në këtë gjendje nga Korona virusi dhe do të ishte mirë sigurisht që edhe më herët pra në mbledhje të KPF-së të parashihen këto mjete, për shkak se veç ishim në këtë situate mirëpo si do qoftë ne grupi i PDK-së do ta mbështesim këtë pikë që të futet në rendin e ditës, për shkak se jemi në një gjendje pothuajse të jashtëzakonshme pra e mbështesim që edhe kjo pikë të futet në rendin e ditës. Faleminderit!
**Fehmi Hoxha** – I nderuari kryetar, nënkryetar, kryesues, të nderuar kolegë kuvendarë, drejtorë të drejtorive, media dhe ju të pranishëm në sallë. Para se të miratojmë rendin e ditës, unë në cilësinë e kuvendarit duke u bazuar në rregulloren e kuvendit komunal po e propozoj edhe një pikë shtesë të rendit të ditës. Duke marrë parasysh situatën e krijuar në rrethana që jemi tani të pandemisë Korona virusi Covid-19 dhe duke ditur që një pjesë e madhe e bizneseve të vogla të Komunës se Rahovecit për shkak të vendimeve të qeverisë se Republikës së Kosovës për mbyllje të veprimtarisë që është shumë normale të shumicës se bizneseve edhe bizneset e Komunës se Rahovecit si të gjithë të tjerët po pësojnë në aspektin ekonomik. Prandaj pasi që është në vendimmarrjen tonë pra të kuvendit komunal të Rahovecit, unë i kam disa propozime për një pikë shtesë të rendit të ditës: Të lirohen nga qiraja të gjitha bizneset që janë duke shfrytëzuar objektet e Komunës për 3 muaj duke filluar nga muaji mars e deri ne fund të muajit maj, të lirohen nga taksat komunale të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit për 3 muaj pra mars-prill- maj 2020 ata të cilët janë të ngarkuar në bazë të rregullores komunale aktuale si dhe mundësisht të subvencionohen të gjithë zejtarët, rrobaqepësit, frizeret, qebaptoret, kafiteritë si dhe bizneset tjera të vogla që do të kenë shumë vështire t'i vazhdojnë aktivitetet pas kësaj situate. Prandaj unë ju ftojë që të më mbështetni dhe pika shtesë të jetë lehtësim i përmbushjes së obligimeve të bizneseve të vogla ndaj Komunës së Rahovecit si dhe subvencionimi për biznese të vogla që operojnë në komunën e Rahovecit. E dimë që edhe bizneset e mëdha kanë nevoja shume të mëdha mirëpo buxheti jonë është i kufizuar, duke u bazuar në ligjin mbi menaxhimin e financave publike, kuvendi komunal i Rahovecit ka të drejtë lëvizje buxhetore deri në 15%. Prandaj unë propozoj që është shumë me rëndësi të dalim nga kjo krizë edhe të gjithë se bashku t'i ndihmojmë aq sa mundemi përpos shëndetit publik të qytetareve të komunës së Rahovecit edhe kapak me i subvencionua bizneset të cilët rrezikojnë në të ardhmen që të mbyllen të gjitha. Këtë po e them që të marrim një vendim deri në 15% që duhet një kohë që me përgatitë drejtori i drejtorisë për financa dhe buxhete edhe t'i japim mundësi kryetarit që atë shumë deri në 15% të autorizojmë që dhe ai të veprojë në bazë të situatës në të cilën jemi, prandaj propozoj edhe këtë pikë shtesë që e lexova më herët. Kërkoj që ta mbështetni sepse është në interesin e qytetareve, më pak tani na duhet investimet kapitale se sa që na duhet të kalojmë këtë gjendjen e jashtëzakonshme edhe pse nuk është e shpallur por është emergjente. Faleminderit shumë për mirëkuptimin tuaj!
**Kryetari** – Përshëndetje shumë për të gjithë kuvendarët, drejtorët e drejtorive, nënkryetarin, kryesuesin, media dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Unë e dëgjova me vëmendje propozimin që e përmendi për pikë shtesë të rendit të ditës që bëri Fehmi Hoxha, pra ne ndoshta nuk është problem edhe mund të dakordohemi t'i lirojmë nga taksat për 3 muaj bizneset për ata që kanë taksa komunale, qiratë e të tjera mirëpo ju e dini që kemi një kodë për mbështetje të bizneseve edhe besoj që mund t'i mbështesim sivjet sikurse i kemi mbështetur edhe vitin e kaluar, ndoshta për këtë vit kostoja mund të jetë shumë e madhe në qoftë se do të futemi me i mbështetë të gjitha bizneset e vogla dhe ne e dimë që kemi mundësi me aplikua ose me marrë vendim në kuadër të buxhetit të përgjithshëm deri në 15% të kemi lëvizje por nëse do të ketë nevojë, ne prapë mund ta thirrmi një seancë të jashtëzakonshme për subvencionim të bizneseve, nuk po flasim për lirim nga taksat sepse është me vend me i lirua nga taksat. Unë jam pro asaj që të futet lirimi nga taksat, nga qiratë për 3 muaj por kjo te

subvencionimi meqenëse ne kemi kod pasi ky kuvendë ka miratuar buxhetin atëherë kisha kërkuar që me mujtë me u kursye pak, për shkak se mund të kemi probleme rreth stabilitetit financiar në Komunë sepse kërkesat mund të jenë shume të mëdha, sa e di unë qeveria e Kosovës ka një plan pra një pako e cila megjithatë mund të ju shërbej së paku këtyre që janë në sektorin privat që janë të regjistruar që mund të kenë disa benificione të cilat natyrisht edhe komunës tonë do të ja lehtësojnë barrën. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë e qesim në votim rendin e ditës me pikat shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**- A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.**

**Sali Sallteku** – Përshëndetje për kryetarin dhe gjithë të pranishmit. Unë sot kam ardhur këtu rastësisht veç kam bisedua me Fehmin sepse nuk kam pasur as email dhe as ftesë dhe s'kam dit që kemi edhe takim pasi nuk kam pasur kurrfarë lajmërimi. Unë pajtohem për të gjitha këto procedura që i tha kryetari për shkak të gjendjes nga virusi Covid-19, mendoj se duhet të kryhen sa më shpejt që të jetë e mundur apo ndoshta ka mundur me krye edhe pa pjesëmarrjen tonë këtë, për shkak të situatës së jashtëzakonshme. Faleminderit!

**Kryetari** – Faleminderit shume, kisha dashtë me na kursye në pikën e dytë të rendit të ditës, e drejta juaj e pacenueshme dhe e patjetërsueshme është me bo pyetje dhe me ngritë shqetësime por edhe nëse keni, unë kisha propozua që në seancën tjetër me ju dhanë përgjigje me shkrim por sidoqoftë ndoshta ju keni nevojë me dhanë ndonjë informacion për sa i takon gjendjes momentale në komunën e Rahovecit që është fat i mirë që jemi gjithë me shëndete edhe kryetari i komunës edhe asamblistët edhe qytetaret e komunës, mos fiksoheni që mund të ketë zgjedhje komunale po besoj që as zgjedhje të përgjithshme nuk do të ketë shpejt ndoshta të shohim për me vonë, deri me tani nuk kemi asnjë rast të dyshuar në komunën tonë, ne kemi krijuar një shtab të posaçëm emergjent, ju njoftojë se asnjë shpenzim serioz nuk e kemi bërë deri me tani, unë falënderoj gjitha bizneset, donatoret pastaj falënderoj KRU-Gjakovën, ekipet vullnetare të QKMF-së, pastaj Eko-drinia, Eko-regjioni dhe gjithë ata që kanë marr pjesë në administrimin e kësaj situate dhe krejt kjo është pa kosto financiare përjashtuar disa tableta që i ka marr QKMF-ja në vlerë 500-600 euro që u deshtë patjetër për dezinfektim. Ju e dini që i kemi dezinfektuar të gjitha objektet komunale, objektet publike, stacionin e autobusëve, stacionin e policisë, objektin e gjykatës, objekte fetare, hapësirat e rëndësishme publike, rrugët dhe rrugicat dhe falë donacioneve që na ka dhënë KRU-Gjakova që e falënderoj publikisht. Po ashtu shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë mjekët, infermieret, punëtorët teknik të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare edhe të gjitha QMF-të e AMF-të që kanë vepruar me seriozitetin ma të madhë sipas bindjes tonë dhe sipas asaj që ne shohim edhe deri më tani është administruar situata shume mirë. Nuk jemi shume të kënaqur me gjendjen pasi nuk kemi shume furnizime nga Ministria e Shëndetësisë sidomos me pajisje mbrojtëse pra këtë çështje e kemi ngritë edhe në nivele të asociacioneve të komunave por sido qoftë deri me tani pasi nuk kemi pasur asnjë rast të dyshuar me këto simptoma të virusit të Covid-19, po besoj që edhe këto ditë që i kemi para vetes, do të përpiqemi me i administrua sa ma mirë që është e mundshme. Po ashtu ju e dini që komuna punon me stafe të reduktuar ose të kufizuar për shkak të rrethanave, shkollat janë të mbyllura pastaj të gjithë mjeket dhe infermieret pa dallim janë në vendin e punës dhe nuk kemi lejuar me marr ndonjë pushim në këtë kohë e as pushim vjetor përveç ndonjë rasti që ka situatë që nuk e kanë gjendjen e mirë shëndetësore edhe ndoshta kemi tolerua, përndryshe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare tash ka disa pajisje të cilat specifikisht mund të përdoren nëse do të kemi ndonjë situate sfiduese pra ndonjë rast të infektuar, por ne besoj që jemi të përgatitur me kapacitetet tona komunale si shtab i posaçëm emergjent me të gjithë akterët që janë të përfshirë, edhe ju në një mënyrë jeni të përfshire përmes kryesuesit të kuvendit të komunës i cili besoj që së

paku ka ruajt kontaktet me përgjegjësit e grupeve politike këtu në Kuvend edhe besoj që këto dhjetë ditë sa kanë mbetur se paku nuk do të kemi, se paku deri me tani nuk kemi ndonjë informacion që mund të na sfidoj deri në këto momente që po flasim pasi kemi të ardhur shumë nga vendet e jashtme dhe e kemi regjistrin e të dhënave, po ashtu kemi evidentua edhe këta që kanë sëmundje kronike, besoj që do të kapërcejmë edhe këtë situate bashkërisht edhe për këto ditë që kanë mbetur, shpresoj që edhe komuna jonë nuk do të preket nga virusi Korona. Ne nuk mund ta parashikojmë saktë këtë mirëpo më qenëse kemi shpëtuar deri me tani atëherë gjasat janë shume të mëdha ne ta përballojmë pa asnjë rast të infektuar me virusin Covid-19. Unë duhet të ju them këto sepse kemi komunikuar në mënyra të ndryshme me publikun, përmes mediave, me organet qendrore te qeverisë, më institutin kombëtar të shëndetit publik, me ministrinë e shëndetësisë, më asociacionin e komunave por edhe me plotë njerëz të cilët kanë kontribuar në ketë drejtim. Falënderoj edhe qendrat tregtare për donacionet si Viva fresh, Superviva, QTX-në, ETC-në, M-Sillosi pastaj Mullirin Burimi dhe Vetoni. Gjendja me furnizime sa i takon pakove ushqimore apo artikujve të shportës është stabile dhe edhe me miell nuk jem keq kështu që edhe gjendja e panikës që u krijua në ditët e fillimit nuk e kemi tani. Ne do t'i shpërndajmë rreth 500 pako ushqimore që do të fillojmë nga dita e sotme përmes qendrës për punë sociale, Kryqit të Kuq dhe kuptohet edhe nga njerëzit të komunës, pasi kam formuar edhe një komision që do të shpërndahet për familjet që kanë nevoja emergjente që janë dhuratë apo që i kanë ardhë komunës së Rahovecit qoftë nga shoqata Jetimët e Ballkanit apo nga qendrat e mëdha tregtare si ETC-ja, QTC-ja, Vivafresh, Superviva po ashtu edhe falënderoj edhe podrumin e vjetër edhe Stonecastle që na kanë dhuruar edhe destilatë për nevoja të parandalimit apo dezinfektimit pra 10000 litra dërstilat edhe për nevojat e Ministrisë së Shëndetësisë e institucioneve tjera shëndetësore kështu që është pae një solidaritet dhe një gatishmëri e përkushtim i të gjithëve e te gjithëve që me mundësitë e veta që i kanë pasur pra i kanë ndihmuar për përballimin me me suksese të kësaj gjendje ose administrimin ma të mire te kësaj gjendje. Edhe njëherë i falënderoj edhe anëtaret e kuvendit të komunës që realisht është gjendje e jashtëzakonshme edhe pse formalisht nuk është e shpallur, kufizimet janë duke i respektuar njerztë në masë të madhe po ashtu edhe kufizimin e lëvizjes që fillon prej orës 17:00 janë duke e respektuar në masë të madhe, inspektoret e komunës së Rahovecit e kanë kryer një punë të jashtëzakonshme pra është fat i mirë që nuk kanë pasur rezistencë fare. Pra qytetaret tanë e kanë kuptuar mire se çfar kërcënimi mund të na vjen nëse nuk e respektojmë masat, rekomandimet, udhëzimet e përcaktuara nga OBSH-ja, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë por edhe nga profesionistet shëndetësor. Unë i falënderoj që të gjithë edhe Kuvendin e Komunës edhe donatoret edhe bizneset pastaj ekipet komunale e parasë gjithash stafin shëndetësore të komunës se Rahovecit që vërtet është për tu befasuar se sa janë të gatshëm dhe të përkushtuar për me krye punën. Ju e dini që e kemi edhe një ekip në Vermicë që janë më shumë se një muaj, sipas orarit të përcaktuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe po ashtu e kemi tash edhe orarin e kujdestarisë se barnatoreve që për fat të keq nuk jemi të kënaqur që Ministria e Shëndetësisë e përcakton një barnatore kujdestare e që unë mendoj që duhet me na dëgjua edhe neve për shkak se ka nevojë për një barnatore kujdestare me qenë në qytete çdo ditë për natën e kam fjalën edhe se paku në Xërxe, Krushë, Ratkoc ka një barnatore, për shkak se ne mund të përballemi me ndonjë situatë që ndoshta ska nevojë me u krijua që të bëj gjithë atë rrugë dikush për me ardh me i marr shërbimet ne barnatoret tona. Faleminderit të gjithëve, unë kaq kisha sa për me tejkalua me mirëkuptim piken e dyte të rendit të ditës.

**Kryesuesi -** Faleminderit shumë kryetar për të gjitha këto informacione, atëherë të nderuar kuvendarë, meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e dytë të rendit të ditës, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit lokal për veprim në Mjedise për vitin 2019-2024.**

**Bjondina Rama** – Përshëndetje për kryetarin e komunës, kryesuesin, asambleistet dhe gjithë ju që jeni prezentë në sallë. Sa i përket planit lokal të veprimit në mjedis, e kemi raportin përfundimtar nga eksperti që është punuar nga Ekoliria. Zbatimi i këtij plani të veprimit në mjedis është angazhuar nga Ekoliria dhe ka

filluar menjëherë pas nënshkrimit të kontratës pasi është bërë një plan dinamik i aktiviteteve dhe ka filluar zbatimin i njëjti në terrene, duke filluar hulumtimin dhe shqyrtimin e te gjitha dokumenteve zyrtare, raporteve, burimeve të shkruara lidhur me mjedisin, në baze të vendimit të kryetarit të komunës, me datë 23.08.2019 është emëruar grupi punues për zbatimin e projektit. Pas emërimit të grupit punues me nismën e këtij projekti është organizuar takimi i parë me anëtaret e grupit punues, është bërë lansimi i projektit, është prezantuar metodologjia e hartimit nga ekipi i projektit. Pastaj ka vazhduar me holumtime, shqyrtime të dokumenteve strategjike, raporteve të legjislacionit, fushave e vizitave në terrene, grumbullim të informacioneve relevante për projektin. Unë mendoj që plani lokal i veprimit në mjedis është një plan që shumë kohë ju ka nevojite komunës tonë ku janë shënuar të gjitha procedurat, takimet dhe informimet që janë marrë me këtë projekte duke marrë parasysh shqyrtimet relevante që i kemi prezentë në komunën tonë. Të dhënat e grumbulluara në fazën e parë nga vizita në terrene dhe palët e interesit kanë bërë vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Të dhënat e siguruara për të gjitha fushat veç e veç dhe vlerësimi i gjendjes ka mundësuar që të jetë sa me konkrete edhe sa me reale sa i përket të gjitha të dhënave. Në këtë planë janë shënuar gjitha gjërat sa me reale dhe që ne mund të i kryejmë për këto vite që është i planifikuar pastaj bashkëpunim me datën 20.02.2020 në sallën e kuvendit komunal që u mbajte debati publik ku ka pasur një pjesë e qytetareve dhe kanë mundur me i shpreh vërejtjet edhe sugjerimet çdo qytetar ose biznes apo ekonomi duke i dërguar, ku më pastaj është dërguar në asamble komunale edhe e kemi mbajtur në komitet për politikë dhe financa ku ka kaluar si pikë. Unë mendoj që është një plan kompleks dhe është gjithçka duke shkuar në bazë të ligjit për mjedis ku e kemi obligim ligjor që del prej ligjit për mbrojtje të mjedisit nga neni 15 ku janë shënuar të gjitha pjesët ku mundem me cekë përshkrimin e aktiviteteve siç i kemi d.m.th. janë detyrimet ligjore, popullsia, klima, struktura demografike, migrimet e popullsisë d.m.th. këto shënohen vetëm në pika të shkurta shënohen njëfarë pasqyre por me rendësi është analiza e gjendjes ekzistuese mjedisore siç e kemi monitorimin e cilësisë se ajrit, vlerësimin e shkaqeve dhe kërcënimit, burimet kryesore të ndotjes, ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësore, rrjeti i kanalizimit, biodiversiteti, vlerësuset pyjore, ekosistemi pyjor, degradimi, menaxhimin e mbeturinave, prodhimi dhe përbërja e mbeturinave, ndriqimi publik, ndotja akustike e ajrit apo zhurma, planifikimi urban, vendbanimet joformale dhe janë vlerësimi i problemeve prioritare sipas fushës dhe ne fund është listë e projekteve prioritare që mendohet në bashkëpunim me komunën dhe me donatore që mund t'i gjejnë, sa i përket aspektit mjedisor që të përfundohen për vitin 2019-2024. Faleminderit!

**Rasim Fazliu** – Ne e kemi shqyrtuar edhe ne KPF këtë pikë dhe fillimisht e përshëndes koordinatoren Bjondina Rama për prezantimin dinjitoz të kësaj pike të rendit të ditës edhe mendoj që ky plan lokal i veprimit për mjedis është mjaft voluminoz edhe ngërthen në vetvete shumë çështje dhe pika që janë për këtë temë që janë në planin e veprimit në komunën e Rahovecit kështu që mendoj që është mjaft i kompletuar ky material edhe aq me tepër është plotësuar në mbledhjen e KPF-së edhe i keni marr parasysh ato vërejtje kështu që mbetet vetëm me falënderuar edhe vazhdojmë me tutje. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për ju, për kryetarin, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë. Kur jemi te plani lokal i veprimit në mjedis për vitin 2019-2024 që është një periudhë afatmesme 5-vjeqare, mendoj që tani e tutje Komuna e ka një plan të tillë, ne kemi lexuar planin me kujdes që është një plan voluminoz, i qartë dhe megjithatë unë kisha me përshëndet grupin punues që ka punuar në këtë plan dhe gjithashtu organizatën Ekoliria. Mendoj se është punuar në mënyrë profesionale dhe është gjithëpërfshirës dhe sigurisht se do të shërbej si një udhërrëfyes edhe më tutje për punën e komunës në adresimin edhe zgjidhjen e atyre problemeve që e karakterizojnë ambientin tonë që sigurisht që duhet me i dhanë rëndësi sepse ambienti uji, ajri dhe toka është pjesë e jetës tonë dhe ja vlejnë me investuar, që sa më i mirë ambienti dhe sa më i pastër ndikon drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e jetës por edhe në mënyrë indirekte në zhvillimin ekonomik të komunës. Janë të përfshira ato tri shtylla në bazë të secilës është i formuar ky plan pra

është analiza e gjendjes mjedisore që mendoj se është bërë një analizë e mirë ku janë të përfshira të gjitha këto fushat si ajri, uji toka, biodiversiteti dhe është një vlerësim që ambienti i ynë është ne gjendje mjaftë të keqe për shkak të ndotjes. Mendoj se është një vlerësim shume real. Tek shtylla e dytë, lista e problemeve mjedisore që ka të bëjë më tepër me identifikimin e problemeve që ndotin ambientin, mendoj që megjithatë është punuar mirë, janë identifikuar të gjitha problemet që është përfshirë ajri, ndotja e ajrit, ndotësit e ajrit dhe gjithashtu ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë po ashtu tek ajri është cekë se mungojnë pikat monitoruese të cilësisë se ajit. Ne dimë se kemi ndotje të ajrit, janë indikatorët që e ndotin edhe ajrin e komunës tonë, tash ne kur flasim shpesh në nivel Kosove pasi jemi pjesë e rrafshit të Dukagjinit që megjithatë kemi edhe diçka më të pasur se sa rrafshi i Kosovës që e dimë edhe arsyen por megjithatë ka faktor që e rrezikojnë edhe ajrin në komunën tonë, prandaj duhet të orientohet komuna edhe në këtë drejtim që të mbrojë edhe ndotjen e ajrit, nuk dua të futem në hollësi që përmenden aty ndotësit e ajrit të cilët janë po ashtu edhe për ndotjen ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë edhe për atë nuk kemi çka të flasim pasi vërtet janë të ndotur shumë, që ceket aty shkarkimet e ujërave të zeza dhe industriale që janë shkaktarët kryesor të ndotjes, kjo është karakteristike për gjithë Kosovën por sigurisht edhe komuna jonë duhet të orientohet në këto drejtime të aktiviteteve të saja në mënyrë që të ketë më shumë projekte në këtë drejtim për përmirësimin e gjendjes. Po ashtu uji higjenik për pije ceket që në komunën tonë që kemi disa fshatra që nuk kanë ujin higjenik për pije për shkak se ujësjellësi i Radoniqit nuk ka qasje në këto fshatrat edhe jepet raporti 87% d.m.th. 13% e popullatës nuk kanë ujë higjenik për pije edhe në këtë drejtim duhet të ketë orientim komuna. Po ashtu edhe për kanalizim gjendja është paksa më e mirë edhe pse e dimë se duhet të punohet edhe ashtu sidomos në menaxhimin e mbeturinave komunale gjithashtu te menaxhimi i mbeturinave komunale prej kohës kur është bërë deponia në Landovicë e dimë që ka përmirësim të gjendjes sigurisht mirëpo megjithatë duhet të punohet në të ardhmen që të eliminohen të gjitha deponitë ilegale që i shohim në vende vende në periferi të qytetit që po besoj edhe nëpër fshatra që janë gjithashtu edhe burim i ndotjes edhe i ujërave edhe i tokës. Pastaj në të ardhmen duhet të punohet sigurisht edhe në selektimin dhe riciklimin e tyre ceket aty, toka degradimi gjithashtu ka mjaftë pune edhe aty, sidoqoftë mendoj te pjesa tjetër e planit të veprimit për zgjidhje mendoj se është bërë mirë sepse aty janë gjitha ato aktivitetet të përfshira që mund të përmblidhen në projekte për të punuar në këtë drejtim rreth këtij plani. Ajo çka ne kërkojmë si delegatë është që komuna tash e tutje të punoj në bazë të këtij plani, të hartoj sa më shumë projekte mbi këtë bazë, sigurisht e dimë që kostoja e tyre është e madhe mirëpo orientimi duhet të bëhet edhe për grande edhe për donacione. Faleminderit!
**Kryesuesi –** Faleminderit shume z. Cena, atëherë meqë nuk kemi tjerë lajmëruar e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit komunal të veprimit për eficiencë për vitin 2019-2020.**

**Përparim Krasniqi –** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit. Unë do të jem pak me i shkurt për shkak se plani për eficiencë të energjisë ka kaluar në të gjitha fazat e debateve publike. Unë po ju njoftoj se ky plan është mbështetur nga Ambasada Gjermane në bashkëpunim me GIZ-in dhe Agjencionin për Energji. Në kuadër të Kosovës, komuna e Rahovecit posedon afërsisht 127 objekte për shkak se plani për eficiencë është plan 3 vjeçar dhe janë të përfshira objektet institucionale, objekte shkollore janë 41, shëndetësore janë 16, administrative dhe objekte tjera janë 21, po ashtu në ndriçim publik janë afër 50 rrugë, po ashtu kemi si data bazë në kuadër të shërbimeve publike pra janë të futura të gjitha të dhënat që janë të mbledhura nga kompania që e ka hartuar këtë plan dhe unë nuk do të zgjatem më shumë për shkak se çdo kush e keni materialin para vetes edhe nëse ka dikush ndonjë pyetje, megjithëse sot ka pasur me ardhur eksperti nga GIZ-i gjerman që të prezanton planin, por për shkak të situatës që jemi nuk kam mundur të vjen sot mirëpo kam marr përsipër që unë te dal këtu dhe të jap shpjegime për ato që i kemi si informatë. Faleminderit!

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit shumë, edhe unë pajtohem me parafolësit me dy shefat e dy partive politike ( PDK dhe LDK), në përgjithësi po dua të them për këto dy projektet pra planet lokale për veprim në mjedis dhe plani komunal për eficiencë janë dy dokumente shumë strategjike për komunën e Rahovecit, edhe është për çdo lavdatë pas një punë kolosale e cikla është bërë nga dy grupet pra drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtoria për Shërbime Publike në këtë rastin e eficiencës edhe vetëm kanë përgëzime sepse kanë punuar shumë edhe kanë bërë një plan fenomenal kështu që komuna e Rahovecit në të ardhmen pasi që i ka këto dokumente strategjike mund të konkurroj në shumë grande që do të kenë qoftë nga Bashkimi Evropian apo nga ministritë e Republikës se Kosovës, kryesisht fokusi kryesor pas miratimit të dy planeve nga ana e Kuvendit Komunal dhe pas certifikimit duhet të fokusohemi tek Ministria e Integrimeve Evropiane si koordinatore e projekteve të IPA-s ku janë shumë grande që mund të përfitoj komuna e Rahovecit pasi që i ka këto dy dokumente strategjike, që me herët nuk i kemi pasur dhe çdo herë kemi hasur në rezistencë edhe pse të tjera i kemi pasur mirëpo mungesa e këtyre dy dokumenteve apo planeve ka qenë mungesë për konkurrim ose marrje të fondeve, kështu që ju përgëzoj. Faleminderit!
**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Hoxha, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të kryetarit të Komunës për shpalljen e interesit të përgjithshëm parcela Nr.P-71510068-01713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, para jush keni propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës 1713-5 në zonën kadastrale në Ratkoc. Qëllimi i shpalljes se kësaj sipërfaqe në interes të përgjithshëm publik është hapja e rrugës Xerxë- Kramovik e cila do t'i shërbej qytetarëve për lëvizjen e lirë. Kjo parcelë është pronësi të dy bashkëpronareve Binak Arif Hoti dhe Ali Jonuz Hoti, sipërfaqe e parcelës për shpallje me interes të përgjithshëm është 5.9 m2. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të miratoj propozim vendimin për interes të përgjithshëm. Faleminderit!
**Kryesuesi** – Faleminderit shume drejtor, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike komunale në fshatin Radostë**

**Afrim Oruqi** – Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Radostë. Qëllimi i këtij propozimi është që t'i jepet një sipërfaqe prej 7.69m2 prej pjesës së përgjithshme të parcelës me Nr. 1043, e cila është e evidentuar në emër të pronës shtetërore e Kosovës pra është një sipërfaqe e madhe dhe ne po kërkojmë prej juve që pas vendimit të Kuvendit Komunal të ndajmë këtë parcelë dhe ta kufizojmë në 7.69m2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme është cekur në pikën 1, ku planifikohet të ndërtohet një objekt i cili do të jetë në shërbim ose në shfrytëzim të përgjithshëm ose në interes të përgjithshëm të komunitetit të fshatit Radostë pra qëllimi i kësaj është që në mënyrë tradicionale dhe kulturore me rastin e zhvillimeve të aktiviteteve të ndryshme në fshat. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të kësaj parcele, kryesisë së fshatit Radoste është për 99vite. Për të gjitha të drejtat dhe obligimet më tutje pas nxjerrjes së vendimit do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të votojnë propozim vendimin që të ndahet kjo parcelë për shfrytëzim të Këshillit të fshatit Radostë. Faleminderit!
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, atëherë nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pike, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

**7. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit të aseteve komunale për vitin 2019.**

**Artan Asllani** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Gjatë vitit 2019 me propozim të Drejtorisë për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm drejtuar kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi janë formuar 5 komisione në lidhje me regjistrimin, vlerësimin, tjetërsimin dhe asgjësimin e tokave të paluajtshme. Të gjitha komisionet e kanë kryer punën e vet në afate kohorë ndërsa gjatë vitit 2019 është bërë edhe regjistrimi 1127 pronave të Komunës së Rahovecit ndërsa shkurtimisht është raporti që janë 3 tabela që janë të përshkruara detyrat dhe punët që janë kryer gjatë vitit 2019. Në tabelën e parë janë regjistrimi mbi vlerën 1000 euro, në të dytën më pak se 1000 euro dhe regjistrimi i tokave. Ndërsa në tabelën e dytë janë të paraqitur përshkrimi dhe artikujt vlera deri më datën 31.12.2019.

**Kryesuesi** – Kalojmë në pikën e radhët të rendit të ditës.

**8. Shqyrtimi i informatës të listës së pronave komunale dhe menaxhimi i tyre.**

**Afrim Oruqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar para juve e keni informatën për pronat komunale si dhe menaxhimi i tyre, të gjitha pronat komunale i keni të paraqitura në informatë në mënyrë tabelare, ki shihet se cilat janë sipërfaqet e tyre, qoftë objekte shkollore, çerdhe, objekte kulturore, palestra sportive, QKMF-të dhe objektet e tjera komunale. Për më shumë rreth kësaj informate nëse keni ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit drejtor për prezantimin e kësaj pike, nëse nuk ka askush tjetër që ta mer fjalën, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

**9. Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndarje të mjeteve financiare.**

Të nderuar arsyetimin e kësaj pika dhamë në fillim të mbledhjes, nëse keni diçka të shtoni sa përket kësaj pike urdhëroni, nëse jo e qes në votim pikën e nëntë të rendit të ditës: Konstatoj se pika e dhjetë e rendit të ditës është aprovuar në mënyrë unanime. Kalojmë në pikën e radhës:

**10. Shqyrtimi i Propozim vendimit dale në ndihmë bizneseve të komunës së Rahovecit.**

**Fehmi Hoxha -** I nderuari kryetar, nënkryetar, kryesues, të nderuar kolegë kuvendarë, drejtorë të drejtorive, media dhe ju të pranishëm në sallë, pasi që si pikë shtesë e rendit të ditës është aprovuar propozimi imë me lejoni që të prezantoj propozimin tim: Duke marrë parasysh situatën e krijuar në rrethana që jemi tani të pandemisë Korona virusi Covid-19 dhe duke ditur që një pjesë e madhe e bizneseve të vogla të Komunës se Rahovecit për shkak të vendimeve të qeverisë se Republikës së Kosovës për mbyllje të veprimtarisë që është shumë normale të shumicës se bizneseve edhe bizneset e Komunës se Rahovecit si të gjithë të tjerët po pësojnë në aspektin ekonomik, të lirohen nga qiraja të gjitha bizneset që janë duke shfrytëzuar objektet e Komunës për 3 muaj duke filluar nga muaji mars e deri ne fund të muajit maj, të lirohen nga taksat komunale të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit për 3 muaj pra mars-prill- maj 2020 ata të cilët janë të ngarkuar në bazë të rregullores komunale aktuale si dhe mundësisht të subvencionohen të gjithë zejtarët, rrobaqepësit, frizeret, qebaptoret, kafiteritë si dhe bizneset tjera të vogla që do të kenë shumë vështire t'i vazhdojnë aktivitetet pas kësaj situate. Prandaj unë ju ftojë që të më mbështetni dhe pika shtesë të jetë lehtësim i përmbushjes së obligimeve të bizneseve të vogla ndaj Komunës së Rahovecit si dhe subvencionimi për biznese të vogla që operojnë në komunën e Rahovecit. E dimë që edhe bizneset e mëdha kanë nevoja shume të mëdha mirëpo buxheti jonë është i kufizuar, duke u bazuar në ligjin mbi menaxhimin e financave publike, kuvendi komunal i Rahovecit ka të drejtë lëvizje buxhetore deri në 15%. Prandaj unë propozoj që është shumë me rëndësi të dalim nga kjo krizë edhe të gjithë se bashku t'i ndihmojmë aq sa mundemi përpos shëndetit publik të qytetareve të komunës së Rahovecit edhe kapak me i subvencionua bizneset të cilët rrezikojnë në të ardhmen që të mbyllen të gjitha. Këtë po e them që të marrim një vendim deri në 15% që duhet një kohë që me përgatitë drejtori i drejtorisë për financa dhe buxhete edhe t'i japim mundësi kryetarit që atë shumë deri në 15% të autorizojmë që dhe ai të veprojë në bazë të situatës në të cilën jemi, prandaj propozoj edhe këtë pikë shtesë që e lexova më herët. Kërkoj që ta mbështetni sepse është në interesin e qytetareve, më pak tani na duhet investimet kapitale se sa që na duhet të kalojmë këtë gjendjen e

jashtëzakonshme edhe pse nuk është e shpallur por është emergjente. Shpresoj se këto propozimet e mija do të gjejnë përkrahje nga ana e juaj dhe do të votohen.

**Kryetari –** I nderuari kuvendar z. Fehmo Hoxha, ju falënderojmë për këto propozime, sa i përket propozimit të pikës së tretë për subvencionim me mjete financiare bizneset e vogla,, ne si komunë për momentin do të shikojmë se çka do të bëjë Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse ajo i ka ndarë disa mjete për këto biznese. Kurse sa i përket dy pikave tjera që i propozuat ju jam pro këtyre pikave.

**Rasim Fazliu –** Po ashtu edhe ne jemi pro pikave të propozuara nga anëtari i ynë z. Fehmi Hoxha.

**Fehmi cena** – Edhe ne si grup i LDK-së e përkrahim propozimin e z. Fehmi Hoxha që këtyre bizneseve të i dilet në ndihmë, qoftë me heqjen e qirasë, qoftë me heqje të taksës komunale.

**Ali Morina -** Po ashtu edhe ne si grup i AAK-së jemi pro dy pikave të propozuara nga z. Fehmi Hoxha.

**Kryesuesi** – Të nderuar anëtar të kuvendit ju faleminderit për diskutimin e bërë, e vëmë në votim propozimin e z. Fehmi Hoxha: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dhjetë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë kuvendarë të nderuar për kontributin e dhënë, shihemi në mbledhjen e radhës.

**Mbledhja përfundoj në 11:00**

**01 Nr. 63/2020**
**Rahovec, 30.04.2020**

**Procesmbajtësi:**

**Agim Hoti**

**K R Y E S U E S I**

**Afrim Dina**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec

Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 433/20 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1
Data/Datum/Date 10 / 04 / 2020
RAHOVEC ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja (j) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, dhe nenit 9, nenit 40 dhe nenit 65, 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës :

## PROPOZON

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin lejohet bartja e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2018 – 2019 në vitin 2020

2. Mjetet vetanake të pa shpenzuara në vitin 2018 dhe 2019 janë në shumë prej **232,776.90 € (dyqind e tridhjetë e dy mijë shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e nëntëdhjetë cent)**, këto mjete do të barten në vitin 2020 dhe lejohen për alokim dhe shpenzim në këto programe dhe kategori ekonomike të caktuara si në vijim:

| | |
|---|---|
| **Investimet kapitale në shumë prej:** | **210,000.90 €** |
| **Mallra dhe Shërbime në shumën prej:** | **850.00 €** |
| **Paga dhe Mëditje në shumë prej:** | **21,926.00 €** |
| **TOTALI** | **232,776.90 €** |

3. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Anëtarët e KPF-së dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

| | |
|---|---|
| Datë/Datum/Date: | |
| Për/Za/To: | z.Smajl Latifi-Kryetar i komunës |
| Nga/Od/From: | z.Afrim Limani-Drejtor për buxhet dhe financa |
| Subjekti/Predmet/Subject: | Propozim |

**I nderuar,**

**Propozojmë që mjetet e mbetura nga të hyrat vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020 të shpërndahen në këto kategori ekonomike:**

1.Pagat dhe mëditjet në shumë prej 21,926,00 euro

2,Mallra dhe Shërbime në shumë prej 850,00 euro

3.Investime Kapitale në shumë prej 210,000,90 euro

Totali .......................................................232,776,90 euro

**Shpërndarja e të hyrave vetanake prej vitit 2018-2019 është si vijon:**

**-Në kategorinë të pagave dhe mëditjeve :**

**1.**Në programin e Shëndetësisë dhe mirëqenie sociale (730),nën programi Shërbimet e shëndetësisë primar (73700) ,kodi funksional (0721) në shumë prej **21,926,00 €.**

**-Në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve :**

**1.**Në programin Arsim dhe Shkencë (920),nën programin Administrata (92055),kodi funksional (0980) në shumë prej **850,00 €.**

**-Në kategorinë e Investimeve Kapitale**

**1.**Në programin Shërbimet Publike (180),nën programi Infrastruktura Publike(18171),kodi funksional (0451).

1.Ndërtimi i rrugëve Vrajak , Ratkoc ,Gexhe, Sapniq,kodi **43465** në shumë prej **37,198,46 €**

2.Ndërtimi i rrugës Ratkoc-Baboc,kodi **43473** shuma prej **16,106,90 €**

3.Ndërtimi i rrugëve në Xërxe ,Celin,Nashpall,Senoc ,kodi **43471** në shumë prej **35,970,00 €**

2.Në programin Planifikimi urban dhe mjedis,(660),nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360),kodi funksional (0620).

1. Kompleksi i dëshmoreve, kodi **40848** në shumë prej **53,499,29 €**

2.Ndërtesa për banim social, kodi **40844** në shumë prej **65,000,00 €**

**3.**Në programin Administrata dhe personeli (163),nën programi Administrata (16311),kodi funksional (0133) .

1.Vendosja e ashensorit në objektin e Komunës, kodi **49841** në shumë prej **2,226,29 €** .

**Ju faleminderit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 434/20 Nr. i faq/Br.str/No.pg 2
Data/Datum/Date 10 /04 /2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/15 qershor 2008), nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**P R O P O Z O N**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, janë në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Gavne Shume, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 116186 m$^2$ (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katror) me numër te certifikatës së pronësisë si më poshtë:
   **2.1.** Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02279-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 42737 m$^2$.
   **2.2 .** Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02280-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 62661 m$^2$.
   **2.3** Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02281-0, jo pjellore me sipërfaqe prej 10788 m$^2$

3. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor me qëllim të ruajtjes së mjedisit duke pasur në konsideratë kontrollin dhe menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave të ngurta si dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatshkurtër në periudhën nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.

5. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2, përcaktohet në përputhje me Rregulloren për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale në bazë mujore.

6. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesit të marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme

7. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.

***Me propozim të njoftohen:***

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit,***
3. ***Anëtarët e KPF-së dhe***
4. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0013827/20 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 10.04.2020 - 13:52 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit)<br>Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa)<br>Last Name / Business Name | Emri<br>Ime<br>First Name | Emri i babait<br>Ime oca<br>Father's Name | Gjinia<br>Pol<br>Gender | Nr. personal/ biznesit<br>Lični broj/broj poslovanja<br>ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja<br>Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit<br>Rođendan/Dan osnivanja<br>Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC | | | /<br>/ | KCID1502327 | KOSOVA /<br>KOSOVA /<br>KOSOVO | | | |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Adresa tjetër<br>Druga adresa<br>Other address | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| RAHOVEC /<br>ORAHOVAC /<br>RAHOVEC | | | RAHOVEC | |

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510057-02279-0 | Rahovec / Orahovac / Rahovec | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / R | | GAVNE SHUME- / GAVNE SHUME- / GAVNE SHUME- | 42737 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 5 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | |
| P-71510057-02280-0 | Rahovec / Orahovac / Rahovec | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / R | | GAVNE SHUME- / GAVNE SHUME- / GAVNE SHUME- | 62661 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 5 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | |
| P-71510057-02281-0 | Rahovec / Orahovac / Rahovec | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / R | | RAVNE SHUME- / RAVNE SHUME- / RAVNE SHUME- | 10788 | Tokë Tjetër - Jo Pjellore - / / Ostalo Zemljiste - Neplodno - / / OtherLand - Unproductive - / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510057-02281-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 10788 |
| P-71510057-02280-2 | | |
| P-71510057-02279-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 42737 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5101

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 10.04.2020

Koha/ Vreme/ Time: 02:00:00

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Povšina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510057-02281-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 10788 |
| P-71510057-02280-2 | | |
| P-71510057-02279-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 42737 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5101

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 10.04.2020

Koha/ Vreme/ Time: 02:00:00

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

PRILL 2020

# KOMUNA E RAHOVECIT
# DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

## Raporti financiar Janar-Mars 2020

**Drejtor: Afrim Limani**

# Përmbajtja

**HYRJE ........................................................ 2**

**1. TË HYRAT VETANAKE ........................................................ 3**

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2019/2020 ........................................................ 3

1.2 Të hyrat e rregullta të realizuara në baza mujore 2019/2020 dhe krahasimi i tyre. ........................................................ 3

1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2013-2020. ........................................................ 3

1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2019/2020. ........................................................ 3

1.5 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike 2020/2019 ........................................................ 4

**2. TATIMI NË PRONË ........................................................ 5**

2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2019/2020 ........................................................ 5

**3. REALIZIMI I BUXHETIT ........................................................ 6**

3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë ........................................................ 6

3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike ........................................................ 6

3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve ........................................................ 8

3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike ........................................................ 11

3.5 Shërbime Komunale ........................................................ 12

# HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimi dhe Shkencë për periudhën Janar – Mars 2020, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave&mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me te njëjtën periudhë Janar-Mars të vitit 2019/2020

Buxheti i Komunës për vitin 2020, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2020, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alo kuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alo kuar,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
- Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

# 1. TË HYRAT VETANAKE

## 1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2019/2020

| Emërtimi | Plani vjetor i të hyrave për 2020 | Realizimi 2019 (Jan-Mars) | Realizimi 2020 (Jan-Mars) | Progresi ndaj planit vjetor 2019 | Progresi ndaj realizimit 2018 (01-03) |
|---|---|---|---|---|---|
| | A | B | C | D=(C/A)*100 | E=(C/B)*100 |
| Të hyrat | **1,156,841.00** | **246,957.39** | **244,511,58** | **-78.86** | **-0.99** |

**-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2018 dhe 2019 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.**

## 1.2 Të hyrat e rregullta të realizuara në baza mujore 2019/2020 dhe krahasimi i tyre.

| Nr | Përshkrimi | Të realizuara 2019 | Të planifikuara 2020 | Të realizuara 2020 | Indexi 5/3 | Indexi 5/4 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 1 | Janar | 67,441.16 | 96,403.42 | 73,433.20 | 8.88 | - 23.83 |
| 2 | Shkurt | 101,728.36 | 96,403.42 | 90,756.67 | - 10.79 | - 5.86 |
| 3 | Mars | 77,787.87 | 96,403.42 | 80,321,71 | 3.26 | - 16.68 |
| | **Gjithsej :** | **246,957.39** | **289,210.25** | **244,511,58** | **-0.99** | **-15.46** |

## 1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2013-2020.

| Periudha | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 61,123.60 | 47,936.41 | 59,440.11 | 53,093.33 | 65,258.72 | 71,296.21 | 67,441.16 | 73,433.20 |
| **Shkurt** | 76,384.19 | 69,513.45 | 63,104.60 | 72,122.01 | 53,970.89 | 79,441.98 | 101,728.36 | 90,756.67 |
| **Mars** | 69,604.65 | 71,192.41 | 73,504.67 | 107,024.34 | 123,917.27 | 100,586.69 | 77,787.87 | 80,321,71 |
| Gjithsej | **207,112.44** | **188,642.27** | **196,049.38** | **232,239.68** | **243,146.88** | **251,324.88** | **246,957.39** | **244,511,58** |

## 1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2019/2020.

<u>Gjobat në trafik në baza mujore</u> <u>Gjobat e gjykatës baza mujore</u>

| Periudha | Gjobat në trafik 2019 | Gjobat ne trafik 2020 | Ndryshimi 2020-2019 | Krahasimi në % 20/ 19*100 | | Gjobat e gjykatave 2019 | Gjobat e gjykatave 2020 | Ndryshimi 2020-2019 | Krahasimi në % 2020/19*100 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 10,566.00 | 20,595.00 | 10,029.00 | 94.92 | | 1,870.00 | 20.00 | -1,850.00 | -98.93 |
| **Shkurt** | 13,285.00 | 18,945.00 | 5,660.00 | 42.60 | | 1,342.70 | | -1,342.70 | -100.00 |
| **Mars** | 10,115.00 | | -10,115.00 | -100.00 | | 1,797.30 | | -1,797.30 | -100.00 |
| Gjithsej | **33,966.00** | **39,540.00** | **5,574.00** | **37.52** | | **5,010.00** | **20.00** | **-4,990.00** | **-99.60** |

<u>Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2019/2020</u>

| Realizimi për vitin | 2019 | 2020 | Krahasimi 2020/2019 |
|---|---|---|---|
| **Te hyrat e rregullta** | 246,957.39 | 244,511,58 | -0.99 |
| **Gjobat e gjykatave** | 5,010.00 | 20.00 | -99.60 |
| **Gjobat ne trafik** | 33,966.00 | 39,540.00 | 16.41 |
| **Te hyrat nga pyjet** | 19.80 | 14.10 | -28.79 |
| **Gjithsej** | **285,953.19** | **284,085.68** | **-0.65** |

**Paraqitja Grafike të hyrat 2019/2020**




## 1.5 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2020/2019

| Kodet | Përshkrimi | Planifikimi për 2020 | Realizimi 2019 | Realizimi 2020 | Ndryshimi në vlere 2020/2019 | Krahasimi 2020/2019 në % | Krahaasimi realizim /planifikim në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **40110** | Tatimi ne prone dhe tatimi ne toke | 541,173.00 | 103,431.27 | 92,436.35 | -10,994.92 | -10.63 | -82.92 |
